



Datë: 27.11.2025

Numër Protokolli: 7681/2025

A.nr.1927/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1927/2025, të datës 21.11.2025, të parashtruar nga ankuesi D.P, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1927/2025, e datës 21.11.2025, e parashtruar nga ankuesi D.P.

A r s y e t i m

Ankuesi D.P(*tutje referuar ankuesi*), më datë 21.11.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1927/2025, kundër Njoftimit të datës 20.10.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e pranimit me numër të referencës: RN00018581, për pozitën e punës “Zyrtar për Regjistrimin e Automjeteve” – Novobërdë, i shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe administrimit të provave vë të çështjes ka gjetur se ankesa **është parakohshme**, sepse:

Nga shkresave e lëndës rrjedhe së Ministria e Punëve të Brendshme më datë 05.09.2025, ka shpallur konkursin me numër të referencës: RN00018581, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm – Arsim i Lartë, pozitën e punës “Zyrtar për Regjistrimin e Automjeteve” – Novobërdë, me afat aplikimi nga data 06.09.2025 deri më datë 05.10.2025.

Rrjedhimisht, sipas provave të lëndë del së në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo, me Njoftimin e 20.10.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPB-së i është refuzuar aplikacioni pe arsyetimin se: “*nuk është dorëzuar një kopje e diplomës siç kërkohet nga konkursi...*”

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundërshton ligjshmërinë e Njoftimit të datës 20.10.2025 për refuzimin e aplikacionit, me pretendimet së ka bashkëngjitur një certifikatë diplomimi të lëshuar nga institucioni kompetent i arsimit të lartë, e cila konfirmon se ka përfunduar të gjitha obligimet e studimit dhe ka marrë titullin që korrespondon me programin e studimeve universitare. Certifikata e diplomimit deri në lëshimin e diplomës ka të njëjtën fuqi ligjore dhe se vendimi për të përjashtuar nga procedura është i pabazuar dhe i parregullt pasi që autoritetet nuk kanë marrë parasysh vlefshmërinë e certifikatës se diplomimit si një provë të përshtatshme të arsimit të fituar. Kërkon që vendimi të rishqyrtohet dhe të mundësohet vazhdimi në fazat tjera të rekrutimit.

Në kuptim të pranushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat Publike gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 i cili përcakton se: *“12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”*, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: *“Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”*, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankuesit e parashtruar më datë 21.11.2025, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidati për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së rekrutimit, ndërsa, ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër njoftimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Pra, meqenëse në kohën e parashtrimit të ankesës së ankuesit të datës 21.11.2025, nuk kishte përfunduar procedura e pranimi sipas konkursit me Nr. Reference: RN00018581, rrjedhë se ankesa e ankuesit A.nr.1927/2025, e datës 21.11.2025, është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat Publike.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës me numër A.nr.1927/2025, nuk mohon të drejtën e ankuesit që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1927/2025

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit D.P;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.